ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *(**Komuna FERIZAJT**)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(**656-20-4406-5-2-1**)*

Sa i përket tenderit për *(**Ndërtimi i objektit te QMF-se ne fsh Softaj.**)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

G&A CONSULTING SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Sali Nivica Nr.19
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/190888 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Gentian Abazi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ga.consulting15@gmail.com
(Adresa elektronike)

10.02.2021 — _____
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K G & A CONSULTING SHTINE

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. *Njoftimi per kontrate dt: 21.08.2020*
2. *Njoftimi per Anulim dt: 08.10.2020*
3. *Vendimi i OSHP-se dt. 24.11.2020*
4. *Njoftim-Vendimi per anulim te aktivitetit te prokurimit dt. 02.12.2020*
5. *Refuzohet Kerkesa per rishqyrtim dt. 08.12.2020*
6. *Vendimi i OSHP-se dt. 12.01.2021*
7. *Njoftim-Vendimi per anulim te aktivitetit te prokurimit dt. 29.01.2021*
8. *Refuzohet Kerkesa per rishqyrtim dt. 04.02.2021*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Proces verbali i hapjes se tendereve i pranuar nga platforma elektronike: 11.09.2020

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [X]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim me datën 02.02.2021 , dhe kemi pranuar pergjigjen me 04.02.2021 ku na është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 42 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 54 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 108-A i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankesa jonë bëhet per arsye se AK ka refuzuar Kerkesen tone per Rishqyrtim te cilin Vendim per refuzim te Kerkese per Rishqyrtim e kundershtojme pasi qe eshte i pa bazuar dhe i kunderligjshem duke na diskriminuar neve si OE pjesemarres ne kete tender dhe te cilet kemi ofruar oferten me te lire te pergjegjshme.

AK ka vepruar kundër nenit 59 të LPP-së përkundër vendimeve të OSHP-së nr: 866-20 të dates 24.11.2020 si dhe vendimit nr: 1102-20 të dates 12.01.2021 cili detyron AK-në Komuna FERIZAJT që të bëjë vlerësimin e tenderit në fjalë. Shkeljen e pretenduar po e potencojmë më poshtë

1. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

5. Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34, 35 të këtij ligji dhe paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, në lidhje me një tender të dorëzuar.

AK edhe pas dy vendimeve të OSHP-së 866-20 I dates 24.11.2020 dhe Vendimit 1102/20 të dates 12.01.2021, Nuk na ka njoftuar me rezultatet e tenderit ,por ka vazhduar me hapat e njejte, duke publikuar Njoftim Vendimin per anulim. AK ka vepruar kunder nenit 59 te LPP.

AK ka vepruar edhe kunder nenit 62, per perfundimin e aktivitetit, pasi qe nuk ka pasur asnje argument,po se vetem ka shkuar direkt ne Anulim

AK nuk ka prezentuar nje Vendim mbi konfirmimin edhe nga ZKA per anulimin e procedures, por permend vetem nje Kerkese nga Njësia e Kerkuese.

Ne si OE I interesuar dhe me oferten me te lire, nuk jemi Njoftuar me Leter standarde per njoftim te OE te sukseshem, te pasukseshem dhe te eleminuar.

Duke qene pale e demtuar dhe AK duke qene subjektive ndaj nesh ne kundershtim me nenet e cekura ka bere Anulimin e tenderit me tendence duke demtuar hapur interesin material.

Edhe pas dy vendimve te OSHP-se të cilat janë cekur me lartë (nr. 866-20 dhe nr. 1102-20) AK nuk e ka zbatuar ate Vendim dhe ka vazhduar me hapat e njejte duke publikuar Njoftim Vendimin per Anulim ku pas atij vendimi ne kemi dorezuar edhe Kerkesen per Rishqyrtim e cila eshte refuzuar.

AK thirret në një Memorandum Bashkepunimi te lidhur me Qatar Charity te datës 29/10/2020, duke e ditur se hapja e tenderit vetem ka qene bere me daten 11/09/2020.
Në bazë te pervojave Organizatat Bamirese Nderkombtare nuk zgjedhin se ne cilat fshatera apo cilat projekte sakte do te financojne por ato propozohen nga pranuesi, AK ka vepruar kunderligjshem kur ka bere marreveshje per tenderin qe ka qene ne procedurat finale te prokurimit, dhe po vepron gjithashtu duke dashur te anuloje tenderin ne fjale. Ne mendojme qe kjo eshte bere me tendenca per te na demtuar Ne, dhe po vazhdohet njeashtu njejte prape duke mos dashur te dije per Vendimet e OSHP-se dy te tilla te nje pasnjeshme te cilat nuk po respektohen.

Bazuar ne arsyetimin per Anulim te Aktivitetit te Prokurimit AK vepron kunderligjshem pasi qe para shpalljes se tenderit ka deponuar Deklaraten e Nevojave dhe disponueshmerise se fondeve per zhvillimin e ketij Aktiviteti te Prokurimit ndersa duke krijuar pretekstin se AK do te beje nje mareveshje mirekuptimi per Ndertimin e QMF-se me Organizaten Qatar Charity dhe tenton te arsyetoje Anulimin e Aktivitetit pasi qe zhvillimi i kesaj procedure nuk do te ishte pengese per bashkefinancim ne ndonje projekt tjeter.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga Bordi i Ankesave te OSHP-se që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE **"G&A CONSULTING"** ***SH.P.K***
ANULOHET Njoftim-Vendimi per Anulimin e procedures se prokurimit nga ana e Komunes FERIZAJT me daten 29.01.2021
DETYROHET komuna e FERIZAJT qe te vleresoje dhe te shpall rezultatet e tenderit ne fjale
OSHP të sjellë një **URDHËRESË** për Komunën e Ferizajt e cila duhet të zbatoj tërësisht Vendimin e OSHP-së

9. Dëmet materiale
Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania jone pëson dëme te konsiderueshme përkundër këtij viti te vështire, ne kemi te punësuar dhe paguajmë paga mujore, dhe se rrezikohemi te afarojme suksesshëm. Demet materiale arrijn ne shumen prej 9000 €

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

*a) një kopje të publikimit të "**Njoftimit për Kontratë**"*

*b) një kopje të publikimit për" apo "**Njoftimit për Anulim**".*

*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.-**NUK E KEMI PRANUAR***

*d) një kopje të **Procesverbalit të hapjes publike** të tenderëve, nëse aplikohet.*

*e) Kopjet e skanuara te kërkesës **për QASJE** ne dokumentet e rezultatit te tenderit*

*f) Kopja e **Kerkeses per Rishqyrtim** derguar AK-se me datë: 13.10.2020*

g) ***Letra rikujtuese** derguar AK-se (Krpp-se) me datën: 21.10.2020*

h) ***Ankesa** e pare derguar **OSHP-së** me datën 29.10.2020*

i) ***Vendimi i OSHP-së nr. 866-20** i datës 24.11.2020*

j) **Njoftim mbi Vendimin e AK-së** i datës 02.12.2020

k) **Kërkesë për Rishqyrtim** e datës 04.12.2020

l) **Vendim per Refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim** i datës 08.12.2020

m) **Vendimi i OSHP-së nr. 1102-20** i datës 12.01.2021

n) **Njoftim mbi Vendminin e AK-së** i datës 29.01.2021

o) **Kërkesë për Rishqyrtim** e datës 02.02.2021

p) **Vendim per Refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim** i dates 04.02.2021

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*